



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Raport Konsultativ për të Hyrat e Lejuara Maksimale

Shqyrtimi Periodik për OSSH

Periudha e Dytë Rregullative (2018-2022)

DEKLARATË

Ky Raport Konsultativ është përgatitur nga ZRRE me qëllim të informimit të palëve të interesit të sektorit të energjisë. Raporti nuk paraqet ndonjë vendim të ZRRE-së dhe nuk duhet të interpretohet si i tillë.

24 gusht 2018



Përmbajtja

1	Hyrje	3
2	Qasja rregullative në sektorin e energjisë elektrike	3
3	Përcaktimi i të hyrave të lejuara maksimale	4
3.1	Metodologjia.....	4
3.2	Struktura e kostove të sistemit	5
4	Procesi i shqyrtimit	6
5	Kostot e operimit dhe të mirëmbajtjes PRR2.....	7
5.1	Opex bazë.....	7
5.2	Kostot e humbjeve	9
6	Kostot kapitale PRR2.....	11
6.1	Baza e Aseteve të Rregulluara	11
6.2	Shpenzimet kapitale PRR2	12
6.3	Zhvlerësimi.....	14
6.4	Kthimi i lejuar	16
7	Zbritjet nga MAR.....	16
7.1	Të hyrat jo-tarifore dhe kostot e përjashtuara	16
8	Përshtatjet e rregullta të vitit 2017 dhe të PRR1.....	17
8.1	Përshtatjet për normën e inflacionit.....	17
8.2	Përshtatjet për kostot e barshtshme	17
8.3	Përshtatjet e kostove të humbjeve.....	17
8.4	Vlerësimi i Bilancit të Energjisë Elektrike të Realizuar - korigjimi në faturim.....	18
8.5	Përshtatjet për të hyrat e pa-rregulluara.....	19
8.6	Përshtatjet për faktorin korigjues të të hyrave	19
8.7	Përshtatjet tjera teknike	20
8.8	Përmbledhja e përshtatjeve.....	20
8.9	Përshtatjet për investimet kapitale në PRR1	21
9	Të hyrat e lejuara maksimale duke përfshirë përshtatjet	22



1 Hyrje

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) është duke kryer Shqyrtimin e Dytë Periodik për Periudhën e Dytë Rregullative (PRR 2), e cila përfshinë periudhën nga 1 prill 2018 deri 31 mars 2023, për të përcaktuar të Hyrat e Lejuara Maksimale (MAR) për Operatorin e Sistemit, Transmetimit dhe Tregut (OST/OT) dhe Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (OSSH).

Ky **Raport Konsultativ** paraqet propozimet e ZRRE-së për MAR që do të mbulohen nga KEDS-i gjatë periudhës së dytë rregullative PRR 2. MAR i miratuar do të përcaktojë tarifat për Shfrytëzimin e Sistemit të Shpërndarjes të cilat do të ngarkohen ndaj shfrytëzuesve të Sistemit të Shpërndarjes. Kostot që rezultojnë nga shfrytëzimi i Sistemit të Shpërndarjes do të përfshihen në tarifat e konsumatorëve fundor të energjisë elektrike. Komentet për këtë Raport Konsultativ mund të dorëzohen në formë elektronike përmes emailit në ero.pricing-tariffs@ero-ks.org ose të dorëzohen në formë të shtypur në adresën e mëposhtme:

Zyra e Rregullatorit për Energji
Departamenti për Tarifa dhe Çmime
Rr. Dervish Rozhaja Nr. 12
Prishtinë, 10000, Kosovë

Data e fundit për komente është **7 shtator 2018**.

Pas shqyrtimit të komenteve të pranuar, ZRRE-ja do të publikojë **Raportin Final së bashku me përgjigje ndaj komenteve** deri me 14 shtator 2018.

2 Qasja rregullative në sektorin e energjisë elektrike

Gjatë PRR2, vetëm kostot e shërbimeve të transmetimit (të ofruara nga KOSTT-i) dhe shërbimet e shpërndarjes (të ofruara nga KEDS-i) i nënshtrohen rregullimit nga ZRRE-ja. Kjo shënon një ndryshim të madh nga PRR1, ku kostot e energjisë me shumicë dhe kostot e furnizimit me pakicë për konsumatorët e shërbyer nga Furnizuesi Publik me Energji Elektrike, gjithashtu janë rregulluar nga ZRRE-ja. Në këtë kuptim edhe çmimi i prodhimit të energjisë elektrike nga KEK Sh.A nuk i nënshtrohet rregullimit, përkatësisht ky çmim nuk aprovet nga ZRRE nga 1 prilli i vitit 2017. Ky ndryshim vjen pas miratimit në vitin 2016 të legjislacionit të ri i cili rregullon sektorin e energjisë në përputhje me Direktivat e Bashkimit Evropian. Me ligjet e reja, është hequr rregullimi i tarifave përfundimtare për të gjithë konsumatorët duke hapur tregun e energjisë elektrike për konkurrencë. Megjithatë, ZRRE do të vazhdojë edhe për një kohë të rregullojë tarifat për kategoritë të cilat gëzojnë të drejtën e furnizimit të shërbimit universal nga furnizuesi i përzgjedhur nga ZRRE. Duhet të theksohet që të gjithë konsumatorët, kanë të drejtë të zgjedhin lirshëm furnizuesin e tyre nën kushte të tregut konkurrues dhe në rast të dështimit të furnizimit të tyre nga këta furnizues, atëherë do ti garantohet furnizimi përmes Furnizuesit të Mundësisë së Fundit (FMF)¹. Përveç kësaj, ZRRE-ja monitoron konkurrencën e tregut të furnizimit me energji elektrike në baza të vazhdueshme dhe mund të ndërhyjë kur identifikon sjellje të cilat dëmtojnë tregun konkurrues.

¹ Rregulla e FSHU dhe FMF janë në dispozicion në faqen e internetit të ZRRE-së në: [http://ero-ks.org/2017/Rregullat/Rregulla%20per%20Vendosjen%20e%20te%20Hyrave%20per%20Furnizuesin%20me%20Sherbim%20Universal%20\(%20Rregulla%20per%20te%20Hyrat%20e%20FSHU\).pdf](http://ero-ks.org/2017/Rregullat/Rregulla%20per%20Vendosjen%20e%20te%20Hyrave%20per%20Furnizuesin%20me%20Sherbim%20Universal%20(%20Rregulla%20per%20te%20Hyrat%20e%20FSHU).pdf)



3 Përcaktimi i të hyrave të lejuara maksimale


3.1 Metodologjia

Për secilin entitet të rregulluar, ZRRE-ja përcakton MAR që do të aplikohet për secilin vit të periudhës PRR2. MAR fillimisht llogaritet në baza vjetore dhe mund të 'profilizohet' përgjatë gjithë periudhës për të shmangur ndryshime të mëdha vit pas viti në tarifa. MAR më pas azhurnohet çdo vit brenda periudhës PRR2 për dallimet në mes të kostove të lejuara dhe të realizuara si dhe të hyrave që janë jashtë kontrollit të të licencuarit.

Llogaritja e MAR ndjek të njëjtën qasje për secilin entitet dhe është përmbledhur më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të llogaritjes së MAR, metodologjive dhe proceseve të përshtatjes, referojuni Rregullës për të Hyrat e OSSH-së të publikuar në faqen e internetit të ZRRE-së:

<http://ero-ks.org/2017/Rregullat/Rregulla%20per%20te%20Hytrat%20e%20OSSH.pdf>

Figura 1: Llogaritja e të Hyrave të Lejuara Maksimale





Llogaritjet kryhen dhe aprovoen në terma real (duke përjashtuar inflacionin) dhe pastaj përshtaten për inflacionin aktual.

Capex-i i rivlerësuar - paraqet shpenzimet përfundimtare kapitale ²(“capex”) për shtim në BARR gjatë PRR1 pas shqyrtimit nga ZRRE-ja të projekteve të planifikuara dhe realizuara dhe kostove të realizuara kundrejt atyre të para-aprovuara.

Capex-i i planifikuar i aprovuar - përfaqëson shpenzimet kapitale të parashikuara të aprovuara për përfshirje në të hyrat e PRR2. Pas përfundimit të periudhës PRR2, këto do të jenë subjekt i shqyrtimit të rezultateve të realizuara kundrejt projekteve dhe kostove të planifikuara të aprovuara dhe BARR për periudhën në vijim do të azhurnohet në përputhje me rrethanat.

Llogaritja e kostos së humbjeve

$$\text{Kostot për njësi (€/MWh)} \times \text{Energjia e shpërndarë (MWh)} \times \text{Lejimi i humbjeve(\%)} = \text{Kostoja e humbjeve(€)}$$

Kostot për njësi dhe vëllimi i energjisë së shpërndarë parashikohen në fillim të periudhës PRR. Brenda periudhës, kosto e lejuar e humbjeve e cila ka kaluar tek konsumatorët azhurnohet çdo vit për diferencat në mes të kostove dhe vëllimeve të realizuara dhe atyre të parashikuara. Përqindja e lejuara e humbjes për çdo vit caktohet përpara periudhës PRR dhe nuk përshtatet gjatë periudhës.

3.2 Struktura e kostove të sistemit

Në vitin 2017, shërbimet e shpërndarjes përfaqësonin rreth 33% të mesatares së faturës së konsumatorit fundor. Shërbimet e rregulluara të kombinuara të transmetimit dhe shpërndarjes përfaqësonin rreth 40% të faturës. Komponenti i vetëm më i madh i faturave është kostoja e energjisë me shumicë (kostot e blerjes nga gjeneratorët vendor dhe importet) që përfaqësojnë gjysmën e faturës përfundimtare. Premiumi i energjisë së ripërtëritshme përfaqëson pagesat e bëra për gjeneratorët e energjisë së ripërtëritshme për të mbuluar diferencën në mes të tarifës së tyre nxitëse dhe çmimit të tregut me shumicë që përfaqësojnë rreth 3% të kostove të sistemit. Tjetër


² Në këtë raport, termi “capex” përdoret për të ju referuar shpenzimeve për blerjen e aseteve fizike. Termi “kosto kapitale” përdoret për të ju referuar kostos së lejuar përkatëse të përfshirë në MAR. Ky lejim është shuma e kthimit dhe zhvlerësimit të aseteve fizike dhe nuk është i barabartë me capex. Për shembull, për një aset me një kosto të investimit prej 10 milion €, një jetëgjatësi prej 40 vjetësh dhe WACC prej 5%, capex është i barabartë me 10 milion € dhe shpenzohet para se aseti të komisionohet për shërbim. Kostot kapitale vjetore, të cilat krijohen në çdo vit në të cilin aseti mbetet në shërbim, janë të barabarta me shumën e: (i) zhvlerësimit të asetit prej 0.25 milion € në vit (10 milion € e pjesëtuar me 40-vjet jetëgjatësi); dhe (ii) kthimi në aset, i barabartë me 0.5 milion € në Vitin 1 (5% e WACC e shumëzuar me vlerën fillestare të asetit prej 10 milion €) dhe që bie më pas pasi që vlera e asetit zhvlerësohet me kalimin e kohës.



komponentë e kostove janë edhe kostot me pakicë të furnizimit, të cilat përfaqësojnë rreth 7% të kostove të gjithmbarshme.

Komponentët e kostove janë të paraqitura në figurën më poshtë.

Figura 2: Komponentët e kostove të sistemit



Shënim: Të dhënat e paraqitura në figurë janë për vitin 2017

4 Procesi i shqyrtimit

Hapat e deritanishëm në procesin e shqyrtimit kanë qenë si më poshtë:

- Shqyrtimi i PRR2 ka filluar në maj 2017 kur ZRRE-ja ka nxjerrë një Raport Inicues që përcaktonte procesin dhe orarin e shqyrtimit.
- Pas kësaj, ZRRE-ja përgatiti dhe nxori shabllonët për të dhëna në maj të vitit 2017 për t'u kompletuar nga KOSTT-i dhe KEDS-i.
- Në qershor të vitit 2017, ZRRE-ja ka publikuar Raportet konsultative për Vlerat Hyrëse për llogaritjet e MAR që mbulojnë Mesataren e Ponderuar të Kostos së Kapitalit (MPKK) të propozuar, lejetimet për humbjet e rjetit të energjisë elektrike dhe jetëgjatësinë e asetëve (që përdoret për qëllimet të zhvlerësimit). KEDS-i dhe KOSTT-i dhanë komente në këto propozime në korrik të vitit 2017.³

³ Kopjet e dokumenteve të konsultimeve rreth vlerave hyrëse janë në dispozicion në faqen e internetit të ZRRE-së, në: <http://www.ero-ks.org/w/index.php/shqip/tarifat-dhe-imet-mainmenu-95/energji-elektrike-mainmenu-96/proceset-e-shqyrtimit-mainmenu-174>



- Dokumentacionet e KEDS-it për PRR2 janë dorëzuar në ZRRE me 12 shtator 2017 në formë të shabllonëve të të dhënave të plotësuar dhe dokumentacionit mbështetës.
- Në mes të shtatorit dhe nëntorit të vitit 2017, ZRRE-ja dhe konsulentët e saj janë konsultuar me KEDS-in për të shqyrtuar dokumentet dhe të dhënat e tyre, për të zgjidhur mospërputhjet dhe mungesat e konsistencës në të dhënat e ofruara dhe për të identifikuar të dhënat shtesë të kërkuara.
- ZRRE më 4 prill 2018 ka publikuar përgjigjet ndaj komenteve të palëve të interesit për parametrat rregullativ.
- ZRRE ka pranuar komente shtesë lidhur me parametrat rregullativ dhe i ka shqyrtuar ato.
- Më datë 20 gusht 2018, Bordi i ZRRE ka marrë vendim në lidhje me parametrat rregullativ për periudhën e dytë rregullative (PRR2).

Seksionet e mëposhtme përmbledhin konkluzionet e shqyrtimit të ndërmarrë nga ZRRE-ja për propozimet për MAR të KEDS-it. Bazuar në këtë, janë prezantuar draft propozimet e ZRRE-së për MAR që do të mbulohet nga KEDS-i gjatë PRR2. Ndonëse është bërë një analizë e gjerë, mbeten disa paqartësi, ku janë kërkuar informata shtesë nga të licencuarit. Këto janë shënuar në pjesët përkatëse të këtij raporti.

5 Kostot e operimit dhe të mirëmbajtjes (OPEX) PRR2

5.1 Opex bazë

Opex-i bazë përbëhet nga disa kategori kryesore: kostot e mirëmbajtjes, kostot tjera operative dhe kostot tjera të cilat janë jashtë kontrollit të KEDS. Qasja e marrë nga ZRRE-ja për caktimin e vlerave për secilën prej këtyre kategorive për periudhën PRR2 është e njëjtë me atë në PRR 1 dhe mund të përmbledhet si vijon:

- Vlera fillestare për PRR2 në vitin 2018 fillimisht është caktuar e barabartë me vlerën e lejuar në mbyllje (në vend të asaj të realizuar) për PRR1 në vitin 2017, duke marrë në konsideratë edhe nevojën e sistemit për performancë më të lartë gjatë periudhës së ardhshme e cila lidhet edhe me shumë obligime ligjore shtesë që do të kenë operatorët. Kjo siguron që të licencuarit nuk u lejohet të tejkalojnë shpenzimet që janë nën kontrollin e të licencuarit, ndërkohë që të licencuarit do të kenë nxitje për të kursyer në kategori të caktuara operative.
- Kjo vlerë fillestare për PRR2 pastaj përshtatet me ndryshimet në kostot që dalin nga obligimet rregullative ose ligjore që konsiderohen të jenë jashtë kontrollit të KEDS-it. Për PRR2, ZRRE-ja ka përfshirë kostot e qirasë për asetet e Trepçës si obligim të ri mbi KEDS-in, kostot që ndërlidhen me përvojën e punës. Këto kosto janë reflektuar në OPEX.
- OPEX-i i vlerësuar për periudhën PRR2 është ndarë në disa kategori kryesore. Vetëm në linjen “Qiraja për asetet e Trepçës” nuk është aplikuar faktori i efikasitetit duke konsideruar atë si linjë e cilat nuk është e kontrollueshme nga KEDS, ndërsa për linjat tjera është aplikuar faktori i efikasitetit.



- Me qëllim të monitorimit të kualitetit të shërbimit dhe performancës, kostot për linjën “Riparimet dhe Mirëmbajtja” janë vlerësuar si linjë e ndarë e OPEX-it. Bazë për vlerësimin e këtyre kostove është marrë niveli mesatar i realizuar në vitet 2014-2017.
- Linja e OPEX-it “Shpenzimet tjera operative” është kalkuluar si diferencë e OPEX-it total nga linja e “Riparimet dhe Mirëmbajtja” dhe “Qiraja për asetet e Trepçës”. Kostot për linjën “Qiraja për asetet e Trepçës” janë të lidhura me kostot e qirasë së infrastrukturës së shpërndarjes së energjisë elektrike që është në pronësi të Ndërmarrjes Trepça. KEDS-i ka kërkuar që ti lejohen 300,000 € në vit për këtë qëllim. ZRRE-ja propozon që kjo të ulet në 246,000 € që është mesatarja e pagesave të realizuara në mes të viteve 2013 dhe 2017 (periudha PRR1).
- Shpenzimet operative të vlerësuara për vitin 2018 pastaj parashikohen për pjesën e mbetur të periudhës PRR2 duke u përshtatur për përmirësimet e pritshme nga efikasiteti vjetor. ZRRE-ja do të nxjerrë edhe një raport të veçantë për të shpjeguar se si janë caktuar këta faktorë të efikasitetit. Për PRR2, ZRRE-ja propozon që të aplikohet një faktor vjetor i efikasitetit prej 1.5% duke filluar nga viti 2019 (d.m.th., KEDS-i pritet që të reduktojë opex-in për 1.5% në vit në terma real, para inflacionit).
- Në kostot e Operimit dhe të Mirëmbajtjes nuk janë të përfshira kostot e shërbimeve të përbëshkëta, në këtë kuptim kostot e OSSH janë neto i të hyrave dhe kostove nga shërbimet e përbashkëta.

Faktori ndarës i kursimeve për kursimet që tejkalojnë faktorin efikasitetit për shpenzimet operative do të ndahen ndërmjet të licencuarit dhe konsumatorëve sipas faktorit 50/50. Në rastin e tejkalimeve të shpenzimeve mbi nivelin e lejuar, ndryshimi i kostove të tilla do të mbulohet nga OSSH, përveç të shpenzimeve të cilat janë jashtë kontrollit të OSSH-së.

Kostot e investimeve përkatësisht kostot e zhvlerësimit dhe kthimit do të përshtaten në baza të arsyeshme aktuale, duke konsideruar çmimet për njësi në treg, për sasitë e realizuara të investimeve. Nëse OSSH, dështon në implementimin e projekteve kapitale në pajtim me orarin e dhënë në planin e aprovuar të investimit, atëherë OSSH duhet ta njoftojë rregullatorin.

Me qëllim të nxitjes në përmirësimin e performancës, në rast se humbjet e realizuara do të jenë më të vogla se humbjet e lejuara të gjitha kursimet do të mbesin tek i licencuari, ndërsa në rast se nuk arrihen e gjithë kosto për mos arritjen e cakut do të mbulohen nga i licencuari.

Duhet të theksohet se kjo qasje është ndryshe nga ajo që është kërkuar nga KEDS-i në aplikacionin e tij, ku një vlerësim i kostove operative është përgatitur për secilin vit të periudhës PRR2 dhe ku nuk është supozuar asnjë përmirësim i vazhdueshëm i efikasitetit. Ky dallim në qasje ndihmon në shpjegimin e dallimeve që rezultojnë në mes të kërkesës së KEDS-it dhe propozimeve nga ZRRE-ja.

Lejimet e propozuara për opex, të zhvilluara siç u shpjeguan më sipër, janë paraqitur në tabelën më poshtë.



Tabela 1: Propozimet e opex-it bazë

€000s	PRR2				
	2018	2019	2020	2021	2022
	Propozuar	Propozuar	Propozuar	Propozuar	Propozuar
Të propozuara nga KEDS					
Riparimet dhe Mirëmbajtja	6,851	6,883	7,018	7,121	6,917
Shpenzimet tjera operative	23,592	23,854	24,240	24,628	25,058
Qiraja për asetet e Trepçës	300	300	300	300	300
Total OPEX	30,743	31,037	31,558	32,049	32,275
Propozimet e ZRRE-së					
Riparimet dhe Mirëmbajtja	4,032	3,971	3,911	3,853	3,795
Shpenzimet tjera operative	21,418	21,152	20,892	20,637	20,387
Qiraja për asetet e Trepçës*	246	246	246	246	246
Kostot e bartshme ⁴	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a
Total OPEX	25,696	25,369	25,049	24,735	24,428

Shënim: Nuk aplikohet faktori i efikasitetit në linjën "Qiraja për asetet e Trepçës"

5.2 Kostot e humbjeve

Për të parashikuar kostot e humbjeve të shpërndarjes duhet së pari të krijohet një bilanc i energjisë, nga i cili mund të vlerësohet vëllimi i përgjithshëm i hyrjeve në sistemin shpërndarjes, lejimi i humbjes në shpërndarje dhe kostot e blerjes së energjisë për të mbuluar vëllimet e humbura.

Bilanci i energjisë i përdorur për këtë qëllim është zhvilluar nga ZRRE-ja duke zbatuar parimet kryesore si në vijim:

- Shitjet e energjisë për konsumatorët e kyçur në shpërndarje përdorin parashikimet e ofruara nga KEDS-i, si Operator i Sistemit të Shpërndarjes, të përditësuara për vitin 2018.
- Humbjet e energjisë elektrike të llogaritura duke përdorur cakun e lejuar të humbjeve nga ZRRE-ja, dhe kjo sasi pastaj i shtohet shitjeve për të fituar energjinë totale të furnizuar përmes sistemit të shpërndarjes.

Kostoja e parashikuar për blerjet e humbjeve ka përdorur çmimet e realizuara në vitin 2017 nga tregu vendor prej 35.43 €/MWh dhe blerjet e energjisë nga importi prej 44 €/MWh. Nga kjo rezulton që çmimi për blerjet e humbjeve të jetë rreth 42 €/MWh për vitin 2018, me një trend të rënies në rreth 40€/MWh në katër vitet në vijim. Këto vlerë janë aplikuar për periudhën rregullative me qëllim të kalkulimit fillestar të kostove të humbjeve.

Edhe pse kostoja e humbjeve azhurnohet në baza vjetore, megjithatë është e nevojshme parashikimi i kostove të humbjeve për të përcaktuar MAR-et fillestare.

⁴ Kostot e bartshme që kanë të bëjnë me obligimet e OSSh për Operatorin e Sistemi dhe Operatorin e Tregut, do të vlerësohen pas përcaktimit të MAR-it të OST/OT-së.



Dallimet që paraqiten nga parashikimi i ndryshëm i çmimeve dhe sasive të lejuara në mes të ZRRE-së dhe KEDS-it, nuk janë relevante, sepse ato do të azhurnohen në baza vjetore, duke konsideruar si kosto jashtë kontrollit të KEDS-it.

Lejimi i humbjeve në shpërndarje është i bazuar në vendimin e Bordit të ZRRE-së për cakun e reduktimit të humbjeve dhe lakoren e humbjeve të lejuara për PRR2 2018-2022.

Tabela 2: Propozimet e kostos së humbjeve

€000s	Njësia	PRR2				
		2018	2019	2020	2021	2022
		Propozuar	Propozuar	Propozuar	Propozuar	Propozuar
Të propozuara nga KEDS						
Energjia që hyn në shpërndarje	GWh	4,760	4,765	4,771	4,779	4,788
Lejimi i humbjes	%	21.90%	20.90%	19.89%	18.90%	17.90%
Humbjet	GWh	1,042	996	949	903	857
Çmimi i blerjes	€/MWh	27.42	31.21	29.23	34.11	35.43
Kostot totale	€000s	28,582	31,081	27,735	30,805	30,364
Propozimet e ZRRE-së						
Energjia që hyn në shpërndarje	GWh	4,539	4,642	4,638	4,636	4,630
Lejimi i humbjes	%	18.80%	18.80%	17.60%	16.40%	15.10%
Humbjet	GWh	853	873	816	760	699
Çmimi i blerjes	€/MWh	42	40	40	40	40
Kostot totale	€000s	35,844	34,906	32,650	30,412	27,964

Energjia që hyn në shpërndarje përfshinë furnizimet në veri të Kosovës

Niveli i lejuar i humbjeve në shpërndarje ka të përfshirë edhe energjinë e shpenzuar në veri të Kosovës si energji e hyrë në OSSH. Në rast se kjo energji nuk do të trajtohet në të ardhmen si pjesë e OSSH-së, atëherë caku i humbjeve do të ndryshojë. Sidoqoftë, varësisht prej trajtimit të energjisë që hynë në sistemin e shpërndarjes, pas aplikimit të cilitdo cak për humbje, volumi i humbjeve duhet të rezultojë i njëjtë.

Tabela 3: Qasjet për kalkulimin e humbjeve të lejuara

Qasja	Njësia	2018	2019	2020	2021	2022
Lejimi i humbjeve (përfshirë rrjedhat fizike të veriut)	%	18.80%	18.80%	17.60%	16.40%	15.10%
Lejimi i humbjeve (duke mos përfshirë rrjedhat fizike të veriut)	%	19.95%	19.95%	18.67%	17.39%	16.04%
Volumi i humbjeve ⁵	GWh	853	873	816	760	699

⁵ Sasia e humbjeve në baza aktuale mund të ndryshojnë varësisht nga rrjedhat e energjisë



Brenda periudhës PRR2, përshtatjet vjetore të kostos së lejuar të humbjeve do të bëhen për dallimet në mes të vëllimeve të shpërndara totale të energjisë së parashikuar dhe realizuar si dhe çmimeve mesatare të blerjes. Humbja e lejuar (si përqindje) mbetet e pandryshuar nga ajo që është treguar këtu.

6 Kostot kapitale PRR2

6.1 Baza e Aseteve të Rregulluara

Gjatë PRR1, shpenzimet e realizuara kapitale nga KEDS-i dallojnë nga ato të lejuara në kohën e aprovimit të MAR të PRR1. Kjo për një sërë arsyesh, duke përfshirë ndryshimin e kërkesave, vonesat në prokurim dhe liferim, identifikimi i alternativave me kosto më të ulët dhe nën ose mbi vlerësim të kostove mes tjerash. Ekzistojnë gjithashtu dallime në mes të projekteve dhe programeve aktuale të ndërmarra dhe atyre të aprovuara në PRR1.

Për caktimin e Bazës së Aseteve të Rregulluara (BARR) për PRR2, ZRRE-ja duhet të identifikoj se cila vlerë e shpenzimeve kapitale gjatë PRR1 duhet të përfshihet në BARR. Parimi i përgjithshëm i aplikuar nga ZRRE-ja është se të licencuarve do tu pranohen kostot e projekteve të aprovuara, nëse këto liferohen në tërësi, dhe projektet tjera që janë ndërmarrë gjatë periudhës por të cilët nuk kanë qenë të aprovuara do të jenë subjekt i dëshmisë rreth nevojës për këto projekte dhe arsyeshmërinë e kostove të tyre.

Për qëllime të këtyre propozimeve, ZRRE-ja ka përfshirë shpenzimet kapitale (capex) të realizuara në PRR1 si vlerë fillestare në BARR të PRR2. ZRRE-ja ka miratuar këtë qasje në bazë të asaj se:

- Ekzistojnë dallime të vogla në mes të vlerave të capex-it të aprovuar (107.2 milion €) dhe të realizuar për PRR1 (100 milion €) dhe, si rrjedhojë, ndryshimet në mes të atyre të lejuara dhe të realizuara do të kompensohen përmes tarifave në PRR2.
- Cilësia e shërbimeve të shpërndarjes në përgjithësi është përmirësuar gjatë periudhës PRR1, e cila mund të konsiderohet si ndikim i investimeve kapitale të lejuara nga ZRRE dhe përfitim për konsumatorët.

Para vendimit përfundimtar të MAR për KEDS, ZRRE-ja do të rishikojë këtë qasje dhe vlerën e capex-it për PRR1 të përfshirë në hapje të BARR për PRR2. Për këtë qëllim, ZRRE-ja ka kërkuar nga KEDS-i që të prezantojë informata shtesë për të shpjeguar dhe arsyetuar dallimin në mes të capex-it të PRR1 të aprovuar dhe realizuar.

Sidoqoftë, në vitin 2017 nga pasqyrat financiare vërehet një dallim krahasuar me vlerën e investimeve të raportuara nga KEDS në propozimet fillestare, andaj ky dallim do të reflektohet gjatë procesit të konsultimeve. Propozimi i ZRRE-së për përfshirje në BARR të PRR2 të vlerës së asetëve të investuara është paraqitur më poshtë



Tabela 4: PRR1 shpenzimet kapitale të përfshira në hapje të BARR për PRR2

Investimet kapitale	€000s
PRR1 aprovuara	107,249
PRR1 realizuara	100,003
Të shtuara në hapje të BARR për PRR2	100,003

6.2 Shpenzimet kapitale PRR2

ZRRE-ja ka bërë një shqyrtim gjithëpërfshirës të shpenzimeve kapitale të propozuara nga KEDS-i për PRR2. ZRRE me mbështetjen e konsulencës së USAID, përmes projektit Repower Kosova, ka bërë vlerësimin teknik dhe financiar të investimeve kapitale të PRR1 dhe vlerësimet për investimet në PRR2.

Ky shqyrtim ka përfshirë elementet në vijim:

- Një shqyrtim fillestar të projekteve dhe programeve të propozuara të përfshira në Planin 5 Vjeçar të Investimeve në Rrjetin e Shpërndarjes (5YNIP) i cili paraqet shpenzimet kapitale të propozuara nga KEDS-i kundrejt atyre të listuara në Planin 10 Vjeçar të Zhvillimit të Rrjetit (10YNDP). Ky shqyrtim identifikon shqetësimet e mëposhtme:
 - Projekti Mitrovice-Shupkovic nuk është në 10YNDP dhe nuk është dhënë asnjë arsytim i veçantë. Ky është larguar nga capex-i i lejuar për PRR2 në pritje të shpjegimeve shtesë nga KEDS-i⁶.
 - Kërkohen informata shtesë për projektet e kalimit në 20 kV të identifikuar në 10YNDP. Nuk është e qartë se cilat nga këto projekte janë të përfshira në 5YNIP (rrjedhimisht në capex të PRR2). Gjithashtu nuk ka shpjegim për periudhën kohore që kërkohet për kalimin në 20kV, apo KEDS të propozoj një qasje në rritje për kalim përmes daljeve individuale dhe jo kalim i tërësishëm. Një çështje tjetër e nevojshme është edhe përpilimi i një plani të detajuar për përshtatjen e nënstacioneve ekzistuese 10/0.4kV që janë në pronësi të konsumatorëve. Në këto propozime, ZRRE-ja nuk ka bërë asnjë përshtatje në capex-in e kërkuar në lidhje me këto projekte por mban të drejtën e zvogëlimit ose heqjes së saj në vendimin përfundimtar nëse nuk ofrohen informatat shtesë që adresojnë këtë shqetësim.
 - KEDS-i ka përfshirë 35.7 milion € për kostot e zëvendësimit të njehsorëve ekzistues shtëpiak dhe të bizneseve të vogla me njehsorë të rinj të mençur. Kjo përfaqëson një nga aspektet më me ndikim në capex-in për periudhën PRR2. ZRRE-ja konsideron se arsytimi i dhënë për këtë projekt është i pamjaftueshëm dhe propozon ta largojë atë nga plani i investimeve. Sqarime më të hollësishme janë dhënë më poshtë.
 - Investimet emergjente – duke u nisur nga gjendja aktuale në sistemin energjetik, e në veçanti në zona të caktuara ku ngarkesa është rritur dukshëm, si dhe nevoja emergjente e integritit të burimeve të ripërtëritshme të energjisë, propozohet që

⁶ Për arsye të fshehtësisë komerciale, kostot e projekteve individuale nuk janë treguar në këtë raport të publikuar.



në planin e investimeve 2018-2022, në nivel të shpërndarjes të përfshihen edhe katër projekte shtesë të përforcimit të rrjetit. Këto investime kapin vlerën e përafërt prej 4 milion € dhe përbëjnë: Projekti i Dragashit, që është i lidhur me integrimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë; si dhe projektet që kanë të bëjnë me përkrahjen e ngarkesës dhe sigurinë e furnizimit siç janë projekti i Fushë Kosovës, projekti i Ferizajt dhe projekti i Malishevës. Të gjitha këto projekte konsiderohen të domosdoshme duke u nisur edhe nga vonesat e investimeve në nivel të transmetimit.

- Është bërë një shqyrtim i kostove mesatare për njësi të KEDS-it për artikujt kryesor të investimeve kundrejt operatorëve rajonal për të vlerësuar arsyeshmërinë e kostove. Ky shqyrtim ka arritur në përfundim që kostot e propozuara të KEDS-it janë brenda kufijve të pranueshëm.
- Analiza të detajuara për kostot dhe benefitet (AKB) e projekteve madhore⁷, të cilat duhet të arsyetojnë se ato janë të nevojshme dhe përfaqësojnë opsionin që ka koston më të ulët. Aty ku nuk është ofruar AKB, arsyetimi për mungesën e saj është adresuar. ZRRE-ja ka arritur në përfundim se AKB-të e ofruara janë adekuate dhe të arsyeshme në supozimet e tyre. Është vërejtur se nuk është ofruar asnjë AKB për projektin e zëvendësimit të njehsorëve, pavarësisht madhësisë së tij. Arsyetimi i dhënë nga KEDS-i për këtë projekt është se ky është një obligim ligjor, mirëpo ZRRE-ja thekson se nuk ka ndonjë obligim ligjor për instalimin e njehsorëve specifik (sic mund të jenë njehsorët e mençur), mirëpo KEDS do duhej të paraqiste një studim të detajuar për instalimin e njehsorëve të tillë dhe pastaj ZRRE të vendosë për arsyeshmërinë e tij.
- Shqyrtimi i ZRRE-së gjithashtu ka identifikuar se plani i investimeve të KEDS-it supozon komisionimin e 10 nënstacioneve të reja të TL/TM brenda periudhës së PRR2. Investimi në pjesën e TL dhe në transformatorë të TL/TM në këto nënstacione është përgjegjësi e KOSTT-it, dhe investimet në pjesën e TM, kryesisht në nënstacione të reja, është përgjegjësi e KEDS-it. Megjithatë, 4 prej nënstacioneve të propozuara nuk paraqiten në planin përkatës të investimeve të KOSTT-it. Përderisa ZRRE-ja konsideron se capex-i i lidhur me këto nënstacione të reja duhet të largohet, duke marrë parasysh faktin që mungojnë investimet që përputhen me KOSTT-in, nuk është e mundur që të identifikohet ndaras capex që lidhet me to nga aplikacioni i KEDS-it. ZRRE ka bërë disa përshtatje konform planit të harmonizuar të investimeve në mes të KOSTT dhe KEDS, por do të kërkoj nga KEDS-i që të japë detaje tjera që lidhen me këto investime dhe të cilat do të vendoset nga ZRRE nëse do të përfshihen apo jo në capex-in përfundimtar.

Sa i përket programit për zëvendësimin e njehsorëve, KEDS-i ka argumentuar në dokumentet e dorëzuara se instalimi i njehsorëve të mençur është obligim ligjor. Ashtu siç u potencua më lartë, ZRRE nuk pajtohet me konstatimin e KEDS. Obligimi përkatës është i përcaktuar në Nenin 23 të Kushteve të Përgjithshme të Furnizimit me Energji Elektrike dhe thotë si në vijim :

⁷ Në bazë të Rregullës për vlerësimin e investimeve kapitale, AKB duhet të përgatitet për projektet të cilat kalojnë vlerën 1 milion euro.



5. *Sisteme inteligjente të njehsimit që mundësojnë pjesëmarrjen aktive të konsumatorëve në tregun e furnizimit me energji elektrike mund të vendoset duke pasur në konsideratë:*
- 5.1. *zbatimin e sistemeve të tilla të njehsimit apo matjes që i nënshtrohet një vlerësimi ekonomik të të gjitha shpenzimeve dhe përfitimeve afatgjate për tregun dhe konsumatorin individual, apo të formës së matjes inteligjente që është ekonomikisht e arsyeshme dhe efektive në kosto, si dhe afatit që është i arsyeshëm për shpërndarjen e tyre. Vlerësimi i tillë do të bëhet deri më 1 janar 2020. Sipas atij vlerësimi, Rregullatori përgatit një tabelë afatesh me cak deri në dhjetë (10) vjet për zbatimin e sistemeve inteligjente të matjes.*
- 5.2. *nëse instalimi i njehsorëve inteligjentë vlerësohet pozitivisht, së paku tetëdhjetë përqind (80%) e konsumatorëve do të pajisen me sisteme inteligjente të matjes deri më 2025.*

Deri më tani, nuk është dorëzuar asnjë studim i fizibilitetit dhe për këtë arsye është e papërshtatshme për KEDS-in që të supozoj se një studim i ardhshëm që do të përcaktojë se njehsorët e mençur kanë një neto përfitim ekonomik dhe të supozoj se çdo proces për instalimin e njehsorëve është paraparë nga ZRRE-ja dhe duhet të plotësohet nga ana e KEDS-it. Si plotësim i studimit të fizibilitetit, KEDS do të mund të propozojë një pilot projekt eventual që do të shërbente vlerësimit final mbi arsyeshmërinë teknike dhe ekonomike të këtij projekti.

ZRRE-ja pranon se përfundimi i zëvendësimit të njehsorëve të vjetruar mekanik me njehsorë digjital është i dëshirueshëm dhe fton KEDS-in që të dorëzojë një propozim për capex të rishikuar bazuar në këtë, në vend të shtrirjes së gjerë të njehsorëve të mençur. Kjo çështje është subjekt i shqyrtimit të ZRRE-së dhe plani i rishikuar mund të përfshihet në vendimin përfundimtar për MAR të KEDS.

Një krahasim përmbledhës i shpenzimeve kapitale nëpër vite ashtu siç është kërkuar me aplikacion nga KEDS-i dhe propozimet e ZRRE-së janë dhënë më poshtë. Paraqitja nga KEDS-i përfaqëson një rritje prej 54 milion € (54%) krahasuar me capex-in e lejuar për PRR1. Pas përshtatjes së përshkruar më sipër, ZRRE-ja propozon një rritje në capex për periudhën e ardhshme pesë vjeçare prej 24 milion € në krahasim me atë në PRR1.

Tabela 5: Propozimet për shpenzimet kapitale PRR2

€000s	Totali	PRR2				
		2018	2019	2020	2021	2022
		Propozuar	Propozuar	Propozuar	Propozuar	Propozuar
Të dorëzuara nga KEDS						
Shpenzimet kapitale	153,859	28,921	36,385	38,314	27,130	23,108
Propozimet e ZRRE-së						
Shpenzimet kapitale	131,443	28,483	33,737	28,846	20,510	19,867

6.3 Zhvlerësimi

Zhvlerësimi llogaritet ndryshe për asetet para-PRR1 dhe për asetet e shtuara në BARR gjatë PRR1 dhe PRR2. Për asetet para-PRR1, aplikohet një jetëgjatësi e mbetur standarde e mesatares së



ponderuar të aseteve. Asetet e shtuara gjatë PRR1 janë të ndara në një të ndarë nga tri kategoritë me jetëgjatësi mesatare të supozuar të asetit prej 5, 20 dhe 35 vjet. Asetet e shtuara gjatë PRR2 alokohen në një të ndarë nga shtatë kategoritë me jetëgjatësi të ndryshme të asetit që aplikohet për secilën prej tyre. Këto kategori dhe jetëgjatësia e aseteve që lidhen me to janë paraqitur më poshtë. Propozimi për kategoritë dhe jetëgjatësinë e aseteve janë në dispozicion në faqen e elektronike të ZRRE-së.

Tabela 6: Kategorizimi dhe jetëgjatësia e aseteve e përdorur për llogaritjet e zhvlerësimit (vetëm ato të shtuara për PRR2)

Lloji i asetit	Jetëgjatësia e asetit (vjet)
Ndërtesat e administratës	50
Rrjetet e TM, nënstacionet, transformatorët e energjisë, dhe pajisjet	30
Rrjetet e TU, nënstacionet, transformatorët e energjisë, dhe pajisjet	25
Stacionet e transformatorit,(TMRR dhe TMT) ⁸ dhe pajisjet	15
Pajisjet dhe mjetet matëse, kamionët, vinçat dhe makineria tjetër e punës	10
Mobile, pajisje për zyre	7
Pajisje për punë, pajisje për lexim, vetura, kompjuterë, pajisje të TI dhe softuer	5

Zhvlerësimi që rezulton nga investimet kapitale të propozuara më sipër (shtesat) në PRR 2, janë paraqitur në tabelën më poshtë.

Tabela 7: Propozimet për lejimin e zhvlerësimit

€000s	PRR2				
	2018	2019	2020	2021	2022
	Propozuar	Propozuar	Propozuar	Propozuar	Propozuar
BARR në hapje	159,650	176,130	195,650	209,056	213,481
Investimet (Shtesat)	28,483	33,737	28,846	20,510	19,867
Zhvlerësimi	12,003	14,218	15,440	16,085	17,467
BARR në mbyllje	176,130	195,650	209,056	213,481	215,881

⁸ TMRR dhe TMT janë transformatorët matës të rrymës dhe tensionit



6.4 Kthimi i lejuar

Bordi i ZRRE-së ka vendosur që Mesatarja e Ponderuar e Kostos së Kapitalit (MPKK) për KEDS për PRR2 të jetë 8.3% (llogaritur në baza reale).

Tabela 8: Propozimet për kthimin e lejuar

€000s	Njësia	PRR1	PRR2				
		2017	2018	2019	2020	2021	2022
		Lejuar	Propozuar	Propozuar	Propozuar	Propozuar	Propozuar
BARR Mesatare	€000s		141,175	161,385	180,059	191,186	196,809
MPKK – i propozuar		12.0%	8.3%	8.3%	8.3%	8.3%	8.3%
Kthimi	€000s	15,966	11,717	13,395	14,945	15,868	16,335

7 Zbritjet nga MAR

7.1 Të hyrat jo-tarifore dhe kostot e përjashtuara

Në dokumentet e dorëzuara, KEDS-i ka parashikuar të hyrat jo tarifore-nga aktivitetet tjera të parregulluara. Këto të hyra mund të rezultojnë nga shfrytëzimi i aseteve nga operatorë tjerë ekonomik, të hyrat dhe taksat e kyçjeve e reja, shitja dhe tjetërsimi i aseteve dhe të hyrat nga shërbimet tjera. Duke qenë se OPEX-i i parashikuar mundëson mbulimin e të gjitha kostove, ZRRE-ja, me qëllim që të shmanget numërimi i dyfishtë i zbret këto të hyra nga MAR-i përfundimtar.

Të hyrat e lejuara maksimale nuk duhet të mbulojnë kostot për kryerjen e ndonjë shërbimi (duke përfshirë këtu shërbimet rreth linjave apo stabilimenteve elektrike) që caktohet të jetë shërbim i përjashtuar. Vlerësimi i këtyre të hyrave është i bazuar nga të hyrat e realizuara në vitet paraprake, sidoqoftë në rast se ka dallime ndërmjet të hyrave të parregulluara të parashikuara dhe atyre aktuale ato do të përshtaten në baza vjetore. Të hyrat jo-tarifore dhe kostot e përjashtuara janë të paraqitura si vlerë negative gjatë kalkulimit të MAR-it përfundimtar. Vlera e këtyre të hyrave jo-tarifore është parashikuar të jetë konstante gjatë PRR2 në vlerë prej 3.5milion€.



8 Përshtatjet e rregullta të vitit 2017 dhe të PRR1

Në këtë pjesë janë paraqitur kalkulimet lidhur me përshtatjet e rregullta vjetore të vitit 2017 dhe përshtatjet për investimet kapitale të PRR1. Kalkulimi i këtyre përshtatjeve do të përfshihet gjatë përcaktimit të të hyrave të lejuara për periudhën rregullative 2018-2022.

8.1 Përshtatjet për normën e inflacionit

Për të bërë kalkulimin e përshtatjeve lidhur me normën e inflacionit, ZRRE si referencë ka marr parasysh normën e inflacionit të publikuar nga Eurostatit për vendet e Eurozonës, e cila për vitin 2017 ishte 1.4%⁹.

Kjo normë aplikohet në përshtatjen e kostove operative, kostove të zhvlerësimit dhe kthimit në kapital. Pas aplikimit të normës së inflacionit prej 1.4% ndaj kompetenteve të kostove të sipërpërmendura rrjedh vlera e kostove të përshtatura prej 0.69 milion euro. Detajet e këtyre kalkulimeve janë paraqitur në tabelën 10:

Tabela 8: Përshtatjet për inflacion

Linja	Njësia	Lejuar	HICP	Kostot e përshtatura
OPEX-i	mil€	23.81	1.4%	0.33
Zhvlerësimi	mil€	9.39	1.4%	0.13
Kthimit	mil€	15.99	1.4%	0.22
Total	mil€	49.20		0.69

8.2 Përshtatjet për kostot e barshtshme

Për shkak të dallimeve ndërmjet energjisë së parashikuar dhe asaj të realizuar nga OSSh lidhur me obligimet e OSSh ndaj Operatorit të Tregut (OT) dhe Operatorit të Sistemit (OS), janë bërë përshtatjet për të reflektuar këto dallime. Vlera e këtyre përshtatjeve është -0.08 milion euro.

8.3 Përshtatjet e kostove të humbjeve

Përshtatja e kostos së humbjeve për OSSH bëhet përmes formulës së mëposhtme:

$$(LSSCat-1 - LSSCft-1) * (1 + It)$$

Vlera e kostos së përshtatur për humbje është 9.26 milion euro, e cila rezulton për shkak të rrjedhave më të mëdha të energjisë të realizuara kundrejt atyre të parashikuara dhe cmimit mesatar për blerjen e humbjeve për vitin 2017 në rrjetin e shpërndarjes. Detajet e kalkulimeve janë dhënë në tabelën më poshtë.

⁹ https://www.ecb.europa.eu/stats/ecb_statistics/escb/html/table.en.html?id=JDF_ICP_COICOP_ANR&period=2017-12



Tabela 9: Përshatjet për kostot e humbjeve

OSSH MAR	Njësia	SHTE11 (2017) E lejuar	SHTE11 (2017) E realizuar
Parametri i indeksimit			
I_t	%		14.87%
Humbjet e lejuara (LSSCt)			
LSSAt	%	18.13	18.13
REUEt	GWh	3,962.1	4,731.3
WHEAt	€/MWh	35.43	44.04
LSSCat-1	mil€		37.78
LSSCft-1	mil€	29.72	
Kostot e përshtatura	mil€		9.26

Ku :

- $LSSA_t$ janë humbjet e lejuara, që janë paraqitur si përqindje e energjisë që hyn në sistemin e shpërndarjes në vitin relevant t
- $REUE_t$ janë njësitë e energjisë (MWh) apo (GWh) që hyjnë në sistemin e shpërndarjes në vitin relevant t
- $WHEA_t$ është mesatarja e kostos me shumicë të energjisë (€/MWh) në vitin relevant t
- $LSSCa_{t-1}$ është kostoja e realizuar e humbjeve të lejuara në vitin relevant t-1, (llogaritur duke përdorur humbjet e lejuara)
- $LSSCf_{t-1}$ është kostoja e parashikuar e humbjeve në vitin relevant t-1, (llogaritur duke përdorur humbjet e lejuara)
- I_t është norma e interesit për vitin relevant t, që llogaritet bazuar në EURIBOR plus S%, ku S paraqet vlerën që do përcaktohet nga Rregullatori gjatë shqyrtimeve periodike që reflekton preminë e pagueshme nga i licencuari për huatë afatshkurtra mbi normën e EURIBOR-it

8.4 Vlerësimi i Bilancit të Energjisë Elektrike të Realizuar - korigjimi në faturim

Pas vlerësimit të të dhënave për vitin 2017 të raportuara si të realizuara, ZRRE ka vërejtur se rezultojnë një sasi e energjisë prej 85 GWh si energji e pa balancuar. Ky dallim është korigjuar nga ZRRE me qëllim të balancimit të bilancit të energjisë elektrike për vitin 2017.

Analiza e bilancit të realizuar për vitin 2017 dhe është paraqitur në tabelën në vijim:



Tabela 10: Korrigjimi në faturim

Bilanci i energjisë elektrike ne OSSH	Njësia	2017 Realizimi
Hyrja në OSSh	GWh	4,996.6
Energjia e pafaturuar në Veri	GWh	265.3
Hyrja në OSSh pa energjinë e pa faturuar	GWh	4,731.3
Hyrja në OSSh pa energjinë e pa faturuar	%	5.3%
Humbjet teknike dhe komerciale në OSSh	GWh	1,199.0
	%	24.0%
Gjithësej humbjet	GWh	1,464.3
	%	29.3%
Energjia e mbetur për faturim	GWh	3,532.3
Faturimi nga KEDS	GWh	3,447.1
Korrigjimi në faturim	GWh	85.2

Vlera e kësaj energjie të mbetur është shndërruar në energji për faturim bazuar në çmimin mesatar të realizuar në OSSH tek kategoria 0.4kV. Pas aplikimi të atij çmimi, rezulton se vlera e energjisë si korrigjim në faturim në OSSH duhet rritur për 1.9 milion euro, përkatësisht duhet kompensuar konsumatorët për këtë vlerë. Në të kundërtën mos shndërrimi i kësaj energjie si energji për faturim do të duhej reflektuar në humbjet e OSSh-së.

8.5 Përshtatje për të hyrat e pa-rregulluara

Të hyrat të tjera të realizuara nga aktivitetet e pa-rregulluara siç janë: të hyrat nga dhënia me qira e aseteve, të hyrat nga operatorët e ndryshëm ekonomik, shitja e aseteve, shërbimet e ndryshme ndaj konsumatorëve, etj, zbriten nga të hyrat e lejuara maksimale. Vlera e këtyre të hyrave të realizuara nga OSSh në vitin 2017 është raportuar nga KEDS-i të jetë 5.78 milion euro, mirëpo ZRRE ka marr vlerën e realizuar e të hyrave nga shërbimet e përjashtuara nga pasqyrat financiare të audituara dhe këto më pastaj i ka zbritur nga MAR-i i propozuar për periudhën e ardhshme rregullative.

Vlera e të hyrave nga shërbimet e përjashtuara pas aplikimit të normës së interesit rezulton të jetë -8.52 milion euro , andaj kjo vlerë do tu kthehet konsumatorëve përmes aplikimit të tarifave në PRR2.

8.6 Përshtatjet për faktorin korrigjues të të hyrave

Ndryshimi në mes të të Hyrave të Lejuara nga ZRRE-ja për SHTE11 (vitin 2017) dhe të Hyrave të realizuara nga OSSH gjatë periudhës së njëjtë është llogaritur sipas formulës në vijim:

$$KREV_t = (AAC_{at-1} - ARR_{t-1}) * (1 + I_t)$$



Ku janë:

AAC_{at-1}	<i>Kostot e lejuara aktuale për vitin relevant t-1 ("Actual Allowed Cost as determined in Relevant Year t-1")</i>
ARR_{t-1}	<i>Paraqet të hyrat e realizuara në vitin relevant t-1 ("is the Actual Regulated Revenues in Relevant Year t-1")</i>
I_t	<i>Norma e interesit për vitin relevant t, që llogaritet bazuar në EURIBOR plus S%, ku S paraqet vlerën e përcaktuar nga ZRRE-ja gjatë shqyrtimeve periodike që reflekton preminë e pagueshme nga i licencuari për hua afatshkurtra</i>

Në vend të kostove aktuale të lejuara AAC_{at-1} është marr MAR-i i lejuar, ngase kostot e përshtatjeve dmth kostot aktuale të lejuara barten në periudhën e ardhshme, prandaj AAC_{at-1} është konsideruar të jetë e barabartë me MAR-in e lejuar.

Ndryshimi në mes të MAR të lejuar nga ZRRE-ja prej 67.53 milion € dhe të hyrave të realizuara (ARR) nga OSSH-ja prej 77.25 milion € (përfshirë korrjimin në faturim dhe të hyrat e pa-rregulluara) përshtatet në PRR2. Vlera e kësaj përshtatje pas indeksimit të normës së inflacionit rezulton të jetë -11.16 milion euro (duke përfshirë korrjimin në faturim prej 1.91 milion euro).

8.7 Përshtatjet tjera teknike

Këtu bëjnë pjesë përshtatjet për shkak të aplikimit të përditësimit të të dhënave të cilat gjatë procesit të vendosjes së të hyrave të lejuara maksimale kanë qenë preliminare. Këto përshtatje kanë të bëjnë me aplikimin e normës së azhurnuar të inflacionit HICP dhe faktorit të korrjimit të të hyrave. Vlera e këtyre përshtatjeve është 1.29 milion euro.

8.8 Përmbledhja e përshtatjeve

Vlera totale e këtyre përshtatjeve është -8.53 milion euro. Përmbledhja e rezultateve të përshtatjeve është paraqitur në tabelën më poshtë

Tabela 11: Përmbledhja e përshtatjeve të vitit 2017

Komponentët e kostove të përshtatura	mil€
Përshtatjet për normën e inflacionit	0.69
Kostot e bartshme	-0.08
Kostot e humbjeve	9.26
Korrjimi në faturim	-1.91
Të hyrat e pa-rregulluara	-8.52
Faktori korrigjues i të hyrave	-9.26
Përshtatjet tjera teknike	1.29
Total	-8.53



8.9 Përshtatjet për investimet kapitale në PRR1

Ekzistojnë një numër projektsh kapitale të cilat ishin përfshirë në planin e aprovuar të investimeve për PRR1 por të cilat nuk janë realizuar. Në këto raste, ZRRE-ja aplikon përshtatjen e 'rikthimit' të zhvlerësimit të lejuar dhe kthimit të lejuar që lidhet me këto projekte të cilat kanë qenë të përfshira në MAR të PRR1. Konsumatorët do të kompensohen për këto përshtatje gjatë PRR2. Kjo e pengon KEDS-in që të përfitoj nga propozimi i projekteve të investimeve ku kostot e tyre janë të përfshira në MAR por të cilat në të vërtetë nuk i ka implementuar. Përshtatjet e periudhës së parë rregullative (PRR1) janë të kalkuluara mbi bazën e asteve të cilat përfshijnë grantet dhe ato të cilat nuk përfshijnë grantet. Ashtu si në përshtatjet tjera, kalkulimet janë bërë duke marr parasysh vlerën kohore të parasë.

Vlera e përshtatjeve të (PRR1) është -1.69 milion euro. Detajet e kalkulimeve janë dhënë në vijmë:

Tabela 12: Përshtatjet për PRR1 për CAPEX

Lejuar	Njësia	2013	2014	2015	2016	2017
Zhvlerësimi	mil€	6.52	7.31	8.05	8.75	9.39
Kthimi	mil€	8.38	10.47	12.38	14.22	15.99

Aktuale	Njësia	2013	2014	2015	2016	2017
Zhvlerësimi	mil€	6.71	7.61	8.45	9.49	10.49
Kthimi	mil€	8.27	9.89	11.39	13.15	14.86

Përshtatjet	Njësia	2013	2014	2015	2016	2017	Total
Zhvlerësimi	mil€	0.19	0.30	0.41	0.74	1.09	2.73
Kthimi	mil€	-0.11	-0.58	-0.99	-1.06	-1.13	-3.87
HICP			0.70%	0.43%	0.21%	0.20%	
It	%	15.58%	15.25%	14.87%	14.90%	14.87%	
Pa-nivelizuar	%	0.15	-0.49	-0.89	-0.43	-0.04	-1.69
I nivelizuar	mil€	-0.34	-0.34	-0.34	-0.34	-0.34	-1.69



9 Të hyrat e lejuara maksimale duke përfshirë përshtatjet

Të hyrat e lejuara maksimale për periudhën e dytë rregullative të paraqitura në tabelën 12 tani do të përshtaten për të reflektuar përshtatjet e vitit 2017 dhe përshtatjet e periudhës së parë rregullative që ka të bëjë me investimet kapitale. Me qëllim që përshtatjet të mos kenë ndikim në likuiditetin financiar të OSSH-së, vlera e këtyre përshtatjeve është shpërndarë në tërë periudhën rregullative 2018-2022, përkatësisht është bërë nivelizimi i tyre.

Tabela 13: MAR i propozuar për PRR2

€000s	PRR2				
	2018	2019	2020	2021	2022
	Propozuar	Propozuar	Propozuar	Propozuar	Propozuar
Baza e Opex-it	25,696	25,369	25,049	24,735	24,428
Kosto e humbjeve	35,844	34,906	32,650	30,412	27,964
Zhvlerësimi	12,003	14,218	15,440	16,085	17,467
Kthimi i Lejuar	11,717	13,395	14,945	15,868	16,335
Kostot e përjashtuara	-408	-408	-408	-408	-408
Të hyrat jo-tarifore	-3,500	-3,500	-3,500	-3,500	-3,500
Përshtatjet 2017- nivelizuar	-1,706	-1,706	-1,706	-1,706	-1,706
Përshtatjet PRR1- nivelizuar	-339	-339	-339	-339	-339
Totali MAR-i i propozuar	79,307	81,935	82,131	81,148	80,241